



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

Ul. Miodowa 10
00-251 Varshavë, Poloni

Tel: +48 22 520 06 00
Fax: +48 22 520 06 05

E-mail: bpri@odihr.pl
osce.org/odihr

Raport nga seminari kombëtar për strehimin social 24 tetor 2012, në Tiranë, Shqipëri

Më datën 24 tetor 2012, projekti Praktikant më të Mira për Integrimin e Romëve (PMIR) organizoi një seminar kombëtar për strehimin social në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit në Shqipëri. Më shumë se 20 pjesëmarrës nga shoqëria civile dhe qeveria u mbledhën së bashku për të diskutuar përfshirjen e romëve dhe egjyptianëve në programet e strehimit social në Shqipëri.

Z. Gentian Kaprata, Drejtor i Planifikimit Urban dhe Strehimit në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT), theksoi se nuk ka pengesa ligjore për pjesëmarrjen e romëve në programet e strehimit social, edhe pse zbatimi praktik i ligjit duhet të shqyrtohet. Ai gjithashtu u bëri thirrje qeverive lokale dhe komunave të promovojnë përfshirjen aktive në strehimin social. Në vitin 2013, ministria do të nxjerrë një skemë grantesh të vogla, ku prioritetet do t'u jepet propozimeve për të përmirësuar kushtet e jetesës për banorët e komunitetit rom.

Znj. Blerina Tepelena, Kryetare e Sekretariatit Teknik të Romëve në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, theksoi se romët dhe egjyptianët shpesh nuk kanë mundësinë të marrin pjesë në programet e strehimit social dhe propozoi masa si për shembull, kuotat e veçanta – për shembull, ofrimi i të paktën 10% të shtëpive që janë ndërtuar për strehim social për familjet e komunitetit rom dhe atij egjyptian. Për më tepër, qeveria duhet të miratojë legalizimin e vendbanimeve joformale të romëve dhe të mbështesë komunitetet romë me materiale ndërtimore bazë për të përmirësuar kushtet e infrastrukturës.

Z. Istref Pellumbi, përfaqësues i organizatës joqeveritare “Romët për Integrim”, tha se është shumë e vështirë për çdo familje që të plotësojë 18 dokumentet zyrtare që nevojiten për të aplikuar për strehim social. Për më tepër, shumica e familjeve romë nuk mund të vërtetojnë të ardhura formale dhe të qëndrueshme në mënyrë që të kenë akses në strehimin social. Për pasojë, familjeve romë u nevojitet asistencë e veçantë dhe konsideratë në këtë proces.

Praktikat më të Mira për Integrimin e Romëve
Mbështetet nga shtetet anëtare të OSBE-së



Projekt i financuar nga BE

Zbatohet nga



Informacion i përgjithshëm

Edhe pse strehimi social është ofruar në Shqipëri për thuhet një dekadë, mënyra se si njerëzit e kuptojnë strehimin social nuk është mjaftueshëm e qartë. Kjo ndodh veçanërisht kur bëhet fjalë për kalimin nga qeveria kombëtare tek ajo lokale dhe tek përfituesit. Për këtë arsye, është e rëndësishme të angazhohemi në një diskutim mbi mënyrën se si kuptohet strehimi social në Shqipëri, në lidhje me:

- **Çfarë është/objektivat e tij?** – një mekanizëm për të siguruar strehim, apo për të ofruar siguri për titujt e pronësisë, apo për të ndërtuar lagje, etj.?
- **Për çfarë shërben?** – grupe me të ardhura specifike, apo grupe të cënuara; apo për vende specifike dhe jo për njerëz, dhe si do të vendosni përparësi nëse grupi i synuar është i madh, etj.
- **Kush është i përfshirë?** – roli i qeverisë lokale (ofruesi), qeveria kombëtare (financimi?/i ligjshëm?), sektori privat (menaxhimi), grupet në komunitet (përzgjedhja?), këshilli i bashkive (përzgjedhja?), etj.
- **A ofron diçka për komunitetin rom dhe atë egjiptian?**

Përdorimi i praktikave të mira

Znj. Ellen Geurts, eksperte e PMIR-it për strehimin social, prezantoi shembujt e mëposhtëm të praktikave të mira nga rajoni dhe vendet e BE-së:

1. **Përmirësimi i vendbanimeve jo-formale** - komunitetet që kanë të ardhura shumë të ulëta mund të ndihmohen në mënyrën më të mirë kur atyre u ofrohet zgjidhje e vetëm 2 nevojat kryesore: siguria e titujve të pronësisë dhe aksesit tek shërbimet bazë (ujë, energji elektrike, kanale të ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave, akses). Përmirësimi i vendbanimeve joformale ofron të paktën këto nevoja të domosdoshme (në kushte ideale shkon përtej kësaj: shkolla, punësim). Kjo mund të ofrohet në formatin e skemave vende-dhe-shërbime, në rast se vendndodhja e vendbanimit joformal nuk është e përshtatshme për përmirësim dhe nevojat e komunitetit të zhvendosen, dhe pastaj u ofrohet një skemë vendi-dhe-shërbimi. *UN-Habitat* ka bërë progres në mbrojtjen e çështjes për përmirësimin e vendbanimeve joformale. [Në njëfarë mase procesi i legalizimit në Shqipëri lidhet me përmirësimin e vendbanimeve joformale, por ai është shumë sipërfaqësor.]
2. **Grante për strehim me vet-ndihmë (jo të ndërtuara vetë)** – komunitetet me të ardhura shumë të ulëta do të kërkojnë grante dhe jo subvencione për t'i siguruar vetes strehim. Kur grantet synojnë drejtpërsëdrejti përfituesit, ka shumë mundësi që ata t'i përmirësojnë vetë shtëpitë e tyre (qoftë duke përdorur aftësitë e tyre për të ndërtuar apo punën lokale). Ekziston rreziku që grantet e transferuara tek përfituesit për të përmirësuar kushtet e strehimit shpenzohen për investime dhe jo për strehim, gjë që nuk është qëllimi i synuar dhe nuk çon në përmirësimin e kushteve të strehimit. Megjithatë, kjo mund të përdoret për nevojat më urgjente të një familjeje, si për shembull arsimimi i një fëmije (gjithashtu diçka pozitive) ose të blejnë të mira për konsum, si për shembull alkool dhe cigare (diçka jo pozitive). Shembuj të mirë të këtyre proceseve mund të gjenden tek *Habitat for Humanity (Vendbanime për Njerëzimin)* (duke ndërthurrur grantet me kreditë).

3. **Skemat jep-me-qira-për-t'u-blerë** – kur strehimi social zhvillohet si një mundësi qiradhënieje, kjo mund të rezultojë në pronësinë e shtëpisë me kalimin e kohës, kur ajo është projektuar sipas skemës jep-me-qira-për-t'u-blerë. Në skemat jep-me-qira-për-t'u-blerë, këstet e qirasë së qiramarrësit vendosen pjesërisht në një llogari kursimi. Këto kursime ose përdoren si një paradhënie për shtëpinë (me hua të tjera nga bankat) ose ato i lejojnë përfituesit të fitojë një periudhë më të gjatë kohore dhe të paguajë plotësisht çmimin e shtëpisë. Kjo skemë nuk përdoret kur strehimi social është projektuar si një mundësi për qiradhënie për të lehtësuar lëvizjen.
4. **Skema të përfitimit të uljes së çmimit/pronësi e shtëpisë sociale** – zbatohet kryesisht për një grup shtëpish ekzistuese publike apo pronë e shtetit, ku shtëpitë shiten me çmime të ulëta për ish 'qiramarrësit'/banorët apo për përfitues të tjerë të përzgjedhur. Në këmbim të çmimit të ulët, nënshkruhet një marrëveshje përfitimi (apo humbjeje) mes shitësit dhe blerësit. Në skemat me ulje të mëdha, normalisht blerësi ka detyrimin t'ia shesë përsëri pronarit. Ky mekanizëm zbatohet në formate të ndryshme për grupe shtëpish publike/sociale në vendet e BE-së.
5. **Strehimi kooperativ apo komunal** – shumë i vështirë në kontekstin e vendeve post-komuniste, duke qenë se shpesh nuk dëshirohet nga banorët. Por ky është një mekanizëm strehimi që nuk duhet harruar në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.
6. **Garantimi i fondeve për sektorin bankar** – i përdorur përgjithësisht në Evropë (Holandë, Danimarkë, p.sh.) për të lehtësuar aksesin tek kreditë për strehim veçanërisht për blerësit që blejnë për herë të parë. E përshtatshme për tregun me të ardhura mesatare dhe jo shumë e përshtatshme për kategorinë me të ardhura të ulëta.
7. **Strehimi i përkohshëm** (shikoni figurën) është një projekt për strehimin social, i cili përfshin modele të ndryshme strehimi, duke filluar nga ofrimi i strehëve për një natë (krevate individuale), deri tek marrëveshjet për jetesë në komunitet, tek apartamentet individuale të vendosura në një vend të vetëm, gjë që gjithashtu i ofron shërbime sociale dhe edukative këtyre mjediseve. Mund të mësoni më shumë për këtë rast studimor tek: <http://www.mh.org.za/projects/bg-alexander>.



Hapat e mëtejshëm

Debati mbi strehimin social është i domosdoshëm për të arritur në hapin e radhës:

- formulimi i politikave të përshtatshme në nivelin kombëtar, por çka është më e rëndësishme brenda kontekstit të legjislacionit shqiptar, politika për strehimin social në nivel bashkie;
- të kuptohet cilët janë **përfituesit e synuar** dhe më pas të kryhet vlerësimi i nevojave të përfituesve të synuar;
- të arrihet në një **model financiar** që mbështet zbatimin e politikës, por që gjithashtu është i zbatueshëm dhe realist për përfituesit e synuar;
- zhvillimi i **titujve të pronësisë dhe modeleve të menaxhimit** që mbështesin modelin financiar, të cilët janë të përshtatshëm për përfituesit e synuar.

Zhvillimi dhe përmirësimi i programeve të strehimit social duhet të fillojë me identifikimin e nevojave të përfituesve. Përfituesit duhet të jenë në gjendje të përdorin programe të ndryshme për të përmbushur nevojat e tyre, si dhe për të ndërthurur programe të ndryshme nëse është e nevojshme.

Për më tepër, strehimi social duhet gjithashtu të integrohet në vendbanime të qëndrueshme për njerëzit dhe të kontribuojë në përmirësimin e jetës në komunitet. Specifikisht, përfshirja e romëve duhet të shkojë përtej strehimit dhe kërkon akses në arsim, punësim, kujdes për shëndetin, etj. Veprimet/politikat favorizuese (për një periudhe të caktuar kohore) mund të eksplorojnë për strehimin, siç është praktikuar tashmë për romët në sektorë të tjerë.